



## **Përshkrimi i Programit**

### **Master i Shkencave në “Menaxhim Agrobiznesi”**

#### **1. Pse një Master Shkencor në “Menaxhim Agrobiznesi” me profilet në “Menaxhim” dhe “Sipërmarrje & Inovacion”**

- Programi është ndërdisiplinor dhe integron aspekte të ekonomisë, menaxhimit, teknologjisë dhe bujqësisë.
- Ai kombinon njohuritë teorike me praktikën dhe kërkimin e aplikuar.
- Programi përgatit studentët për të vepruar në mjedise komplekse dhe dinamike biznesi.
- Ky program ofron dy profile të diferencuara: (i) Menaxhim dhe (ii) Sipërmarrje & Inovacion.
- Programi është i përshtatur me nevojat e ekonomisë shqiptare, perspektivat dhe zhvillimet globale.
- Ai fokusohet në menaxhim, qëndrueshmëri, inovacion dhe zhvillim rural.

#### **2. Kompetencat e të diplomuarve**

- Programi formon profesionistë të aftë për të analizuar zinxhirin e vlerës agroushqimore dhe për të kuptuar dinamikat e tregut.
- Studentët zhvillojnë aftësi të avancuara në vendimmarrje strategjike dhe menaxhimin efikas të projekteve dhe burimeve.
- Përmes një kombinimi të metodave cilësore dhe sasore, programi fuqizon kompetencat kërkimore dhe analitike të studentëve.
- Të diplomuarit përgatiten për të menaxhuar riskun dhe për të zbatuar praktika të qëndrueshme në mjedise të ndryshme profesionale.
- Programi kultivon aftësi të lidërshipt, komunikimit efektiv dhe aftësi të forta ndërpersonale, thelbësore për sukses në karrierë.
- Ai ofron një bazë të qëndrueshme në menaxhimin financiar dhe zhvillimin e iniciativave sipërmarrëse.
- Studentët inkurajohen të identifikojnë dhe zhvillojnë ide inovative duke ndërtuar modele të reja biznesi.

- Programi ofron një perspektivë të gjerë mbi politikat bujqësore dhe zhvillimin rural në nivel evropian dhe global.
- Ai nxit përdorimin e teknologjive digjitale dhe zhvillon aftësi në menaxhimin e inovacionit.
- Të diplomuarit udhëhiqen nga parime të etikës dhe përgjegjshmërisë sociale në vendimmarrje.

### **3. Punëdhënësit e mundshëm dhe/ose rruga e karrierës**

Të diplomuarit mund të punësohen në:

- kompani agrobiznesi dhe të industrisë ushqimore në pozicione menaxheriale dhe operacionale.
- institucione financiare që mbështesin sektorin rural dhe agrobiznesin.
- kompani konsulence ose startup-e dhe iniciativa sipërmarrëse.
- institucione publike dhe agjenci zhvillimi në nivel qendror dhe vendor.
- organizata jofitimprurëse dhe projekte ndërkombëtare zhvillimi.
- institucione akademike dhe kërkimore.
- sipërmarrës në sektorin e agrobiznesit.

### **4. Alumni të cilët mund të shërbejnë si shembull**

#### **1. Klea Ramaliau**

#### **5. Si zbatohet ndërdisiplinarteti i programit?**

- Programi integron njohuri nga ekonomia, menaxhimi, bujqësia, teknologjia dhe mjedisi.
- përdor metoda analitike dhe kërkimore nga disiplina të ndryshme për zgjidhjen e problemeve.
- integron njohuritë teorike me praktikën përmes kërkimit të aplikuar dhe përvojës profesionale.
- adreson sfida ekonomike, sociale, mjedisore dhe teknologjike në mënyrë të integruar.
- kombinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe praktikën në një qasje të vetme.

Programi integron lëndë dhe module nga disa fusha:

- 70% Kredite në shkencat social-ekonomike
- 15% Kredite në shkencat e natyrës
- 15% Kredite në shkenca teknike

Gjatë zhvillimit të këtij programi është ndjekur parimi i qasjes ndërdisiplinore. Programi Master Shkencor në Menaxhim Agrobiznesi me dy profile, (i) ‘Menaxhim’ dhe (ii) ‘Sipërmarrje dhe Inovacion’ është konceptuar si një program i gjerë dhe ndërdisiplinor. Programi kombinon njohuri teorike me kërkimin e aplikuar dhe komponentët praktikë, duke i përgatitur të diplomuarit për të vepruar në mënyrë efektive në mjedise organizative gjithnjë e më komplekse dhe dinamike. Kurrikula është strukturuar për të zhvilluar kompetenca analitike dhe strategjike të nivelit të lartë, duke i mundësuar studentëve të interpretojnë dhe adresojnë sfidat menaxheriale shumëplanëshe. Përmes një qasjeje të integruar ndaj mësimdhënies, kërkimit dhe praktikës profesionale, studentët ekspozohen ndaj perspektivave globale të agrobiznesit, ndërsa inkurajohen t'i kontekstualizojnë

këto brenda nevojave dhe karakteristikave specifike të ekonomisë shqiptare dhe strukturave të saj të tregut në zhvillim.

## **6. Cilat programe Bachelor sugjerohen për këtë Master**

Programi është i hapur për të diplomuar nga fusha të ndryshme:

- ekonomi, menaxhim, finance, marketing dhe fusha të ngjashme;
- agrobiznesi dhe shkenca bujqësore.
- fusha të tjera të lidhura për shkak të natyrës ndërdisiplinore.